

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

Kompania : **Relikaj shpk**

Vendodhja : **Koplik, Malësi e Madhe**

Nr.Nipt : **J78428712T**

Administratore: **Vjollcë Likaj**

Përshkrimi i aktivitetit :

Relikaj shpk, ndodhet afër qytetit të Koplikut, në rrugën e Kalldrunit, Malësi e Madhe. Kompania Relikaj, Aktiviteti i kompanisë shtrihet në fushën e agrobiznesit ku përfshihen grumbullimi, përpunimi, paketimi i bimëve medicinale si dhe me import eksport bimësh medicinale të përpunuara pjesërisht ose si produkt përfundimtar.

Për ushtrimin e aktivitetit të saj, kompania Relikaj ka :

- a. Magazinën e ruajtjes së lëndës së parë
- b. Repartin e përpunimit të lëndës së parë
- c. Reparti i paketimit të produktit
- d. Reparti i ruajtjes së produktit të gatshëm
- e. Fabrika e produktit përfundimtar

Skadenca 3 – 5 vite

Etapat e procesit teknologjik:

Lënda e parë : Relikaj merret me grumbullimin e bimeve medicinale kryesisht sherebelë, trumëz, lavandul, helikrisi etj. Grumbullimi i këtyre bimeve bëhet përgjithësisht në zonën e Malësisë së Madhe, zonë e cila është e njohur për kushte të atilla atmosferike dhe pozicion gjeografik favorizues për rritjen dhe zhvillimin e këtyre bimëve. Për këtë arsye bimët e kësaj zone janë të njohura për parametrat e lartë si ngjyra, vaji, tyjoni.

Procesi teknologjik:

Bimët medicinale magazinohen në ambientet e destinuara për magazinimin e lëndës së parë, të cilat janë të ajrosura, sistemuara sipas kushteve dhe standarteve ndërkombëtare, të cilat ndihmojnë në ruajtjen e cilësisë së produktit.

Pas magazinimit të lëndës së parë, produkti merret sipas kërkesës dhe kalohet tek reparti i përpunimit të lëndës së parë, ku realizohet ndarja e gjethes nga kërcelli, pastrimi nga barërat, pluhurat, lëndët e tjera të huaja.

Faza e 1-Grumbullimi i produktit tek fshataret i cili mund të bëhet vetë nga firma ose duke e sjellur vehtë brenda kompanisë. Produkti duhet të jetë i tharë mirë kryesisht për produktin e verës dhe të ruajë ngjyren pasi është shumë e rëndësishme.

Faza e 2-Tharja i cili është një proces që ndiqet edhe nga vehtë firma kryesisht në rastet kur produkti nuk është tharë sic duhet nga fshatari. Tharja në mënyrën e duhur ka një rëndësi sepse shërben në ruajtjen e tyjonit që është një lloj vaji brenda këtij produkti që ka vlera ushquese.

Faza e 3-Pastrimi fillestar i cili është një proces që realizohet brenda makinerive nëpërmjet shoshave të vecanta.Pastrimi fillestarë është i vecantë sepse bën ndarjen e lëndës së parë nga papasteritë sic mund të jena gurë,dhera ose produkte tjera të pafavorshëm për vazhdimin e procesit.

Faza e 4-Produkti me pas kalon në procesim i cili bëhet në copezimi sipas kërkesave të klientit sepse jo i gjithë produkti mund të kërkohet në të njëjtën formë.

Faza e 5-Bëhet pastrami përfundimtarë duke u larguar të gjitha papasteritë ose kërcejt e ndryshëm.

Faza e 6-Paketimi i produktit bëhet në balla ose ne thase sipas kerkeses se klienteve kur cdo proces ka vendin e tij të caktuar dhe produkti i cili përgatitet nuk ka kontakte me token.Në fund bëhen analizat e produktit qe i dergohen klientit.

Produkti i gatshëm për export paketohet në ballot e presuara dhe në thasë me peshe te ndryshme.

Pas procesit të paketimit, materiali kalohet në magazinën e ruajtjes së produktit të gatshëm.